

Fotografia për mua është pjesë e artit, përmes saj mund të shprehen shumë ndjenja dhe emocione. Kënaqem kur fotografoj dhe veten e shoh si një fotografe profesionale e suksesshme.

Aneta




Të mësuarit e zanatit për mua do të thotë avancim personal dhe mëvetësim si dhe një ardhmëri më e mirë për mua dhe familjen time. Pas përfundimit të trajnimit e shoh veten si pronar i një salloni floktarie që do të ishte një biznes familjar.

Maja



Qysh si e vogël kam dashur të gatuj. Të mësuarit e këtij zanati më përmbush shumë, më bën të lumtur. Ëndërr e jetës për mua është që një ditë të kam restorantin tim buzë detit.

Elena



Të mësuarit e këtij zanat për mua ishte dëshirë që tani u shndërrua në realitet, realitet i cili do të më ndihmojë për t'u punësuar dhe për të filluar një biznes familjar. Jam falënderuese së tepërmi që jam pjesë e këtij projekti.

Jasmina



Projekti "Ndërmerr aksion për konkurrencë më të mirë në tregun e punës" i financuar nga Bashkimi Evropian, në kuadër të Programit Operativ të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore 2007-2013 (Komponenti 4 i IPA)



NDËRMERR AKSION PËR KONKURENCË MË TË MIRË NË TREGUN E PUNËS

"Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Mbështetja e tij është përgjegjësie e vetme e Kryqit të kuq të RM-së dhe e Odës së Zejtarëve të Shkupit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i përfaqësojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian."



Projekti "Ndërmerr aksion për konkurrencë më të mirë në tregun e punës" i financuar nga Bashkimi Evropian, në kuadër të Programit Operativ të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore 2007-2013 (Komponenti 4 i IPA)



NDËRMERR AKSION PËR KONKURENCË MË TË MIRË NË TREGUN E PUNËS



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



Projekti është i implementuar nga Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë

Крвен крст на РМ
Kryqi i kuq i RM

Oda e Zejtarëve të qytetit të Shkupit



Aktivitetet e projektit dhe rezultatet e arritura

Kryqi i kuq i RM-së në gjysmën e dytë muajit dhjetor të vitit 2015 filloi realizimin e Projektit "Ndërmerr aksion për konkurrencë më të mirë në tregun e punës", në partneritet me Odën e Zejtarëve të qytetit të Shkupit, i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Programit Operativ të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore 2007-2013 (Komponenti 4 i IPA), i cili kontribuoi në rritjen e pjesëmarrjes së personave afatgjatë të papunë në tregun e punës me qëllim reduktimin e papunësisë. Përmes identifikimit dhe përzgjedhjes nga gjithsej 210 persona, u zgjodhën 40 persona afatgjatë të papunë nga rajoni i komunave Kisella Vodë, Gjorçe Petrov dhe Gazi Baba.

Zhvillimi i shkathtësive sociale dhe profesionale

Në fillim me përdoruesit janë realizuar 3 trajnime dyditore për avancimin e shkathtësive të tyre sociale që ishin një përgatitje dhe hyrje në punëtoritë për rritjen dhe zhvillimin personal të cilat ndikuan në ngritjen e motivimit të tyre dhe forcimin e potencialeve dhe kapaciteteve të tyre personale. Në këto punëtori është punuar edhe në ngritjen e vetëdijes së tyre lidhur me rëndësinë e marrjes së përgjegjësisë personale në përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike dhe gjendjes së tyre familjare, si dhe në procesin e ndërtimit të personalitetit profesional.

Paralelisht me këto aktivitete dhe gjatë gjithë Projektit për përdoruesit dhe anëtarët e familjeve të tyre të ngushta janë siguruar shërbime psikike-sociale si përgjigje për nevojat e tyre individuale dhe vështirësitë me të cilat përballen, dhe ato në të vërtetë ishin një segment i rëndësishëm i mbështetjes së përgjithshme.

Duke përfunduar trajnimet e zanateve të cilët zgjatën nga 3 dhe 6 muaj, 35 përdorues me sukses dhanë provimin përfundimtar.



Në fazën përfundimtare të projektit janë mbajtur tri tryeza të rrumbullakëta në nivelin lokal me temën "Mundësitë dhe sfidat e punësimit të personave të rrezikuar në pikëpamje sociale": Në tryezat e rrumbullakëta morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Agjencia e Punësimit të RM, komunat, shoqatat qytetare dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm dhe u morën konkluzat dhe rekomandime për veprimin e mëtejshëm për përmirësimin e konkurrencës në tregun e punës dhe rritjen e mundësive të punësimit.

Deklaratat e përdoruesve

Zanatin që e zgjodha me të vërtetë e dua dhe për mua do të thotë mundësi e punësimit.

Esmina

Trajnimet e zanatit janë shumë të dobishme për mua. Më vjen mirë që jam mirëpritur nga të punësuarit dhe që përvojën e tyre në zanatin e bravandreqësve e ndajnë bujarisht me mua. Pas përfundimit të trajnimit do të doja të vazhdoj të punoj atje.

Goce



Të mësuarit e zanatit të rrobaqepësisë për mua është diçka shumë e rëndësishme. Ky zanat më dha mundësinë për të theksuar kreativitetin tim dhe mundësinë për të përgatitur një produkt që ka dalë nga duart e mia – vepër e imja. Mundësi për një fillim të ri dhe një shans për kushte më të mira financiare.

Tanja



Gjatë punëtorive të rritjes dhe zhvillimit personal dhe trajnimit për bukëpjekës, unë u bëra një personalitet krejtësisht tjetër. E përgjegjshme për vendin e punës, me vetëbesim, komunikuese, para së gjithash më e guximshme për të kërkuar punë për dallim nga më parë kur isha shumë e frikësuar se nuk do të kem sukses. Tani jam e sigurt se mund të jem një person i suksesshëm.

Karolina

I gjithë procesi ndikoi në mënyrë shumë pozitive mbi mua, në qoftë se do të kishte një pjesë të dytë sërish do të bashkohesha me kënaqësi të madhe, dhe shprej në një bashkëpunim të mëtejshëm me ekipin e Kryqit të kuq.

Sllavica

Mësova shumë nga ju, ju falënderoj për shkak se tani vetëvlerësohem dhe e çmoj veten dhe kualitetet e mia.

Vesna

Filigrani si zanat për mua ishte një dëshirë e porealizueshme deri tani. Kjo zeje do të jetë kthesë në jetën time dhe në jetën e familjes sime.

Katerina



Për mua zanati do të thotë avancim profesional dhe orientim i tij drejt fillimit të një biznesi të suksesshëm familjar.

Persa

Në kuadër të angazhimit të mëparshëm dhe të tanishëm të punës (punimin e suvenirave dhe punën në fidanishten e luleve) ky avancim është i mirëserardhur për mua dhe me certifikatën që do të marr mund të bëjë përmbylljen e angazhimit tim profesional.

Goran

